



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

**VENDIM**

**Nr. 577, Datë 20.12.2018**

**“Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.12.2018, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”

**Baza Ligjore:** Nenet 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja c) të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, e ndryshuar.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm ;

**VËREN SE :**

1. Depozitimi i dy dosjeve origjinale ose të njehsuara me originalen krijon kosto shtesë për palën njoftuese;
2. Në kuadër të ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit ;
3. Në mbështetje të Ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, në arkivin e institucionit do të depozitohet një dosje për efekt të arkivimit të materialeve;

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja c) të Ligjit 9121/2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, e ndryshuar,

## **VENDOSI:**

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, si më poshtë:

### **Neni 10 i Rregullores ndryshohet si më poshtë:**

1. *Një kopje origjinale ose e njehsuar me origjinalen të njoftimit dhe të dokumenteve bashkëlidhur (të përcaktuara në formularin e njoftimit), duhet të dorëzohen në Zyrën e Arkiv Protokollit të Autoritetit të Konkurrencës.*
2. *Nuk ndryshon.*
3. *Nuk ndryshon.*
4. *Nuk ndryshon.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**